



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 10 gusht 2020
Nr. ref.: RK 1599/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI215/19

Parashtrues

Fekë Kuçi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit AA. nr. 524/2018 të
Gjykatës së Apelit, të datës 10 prill 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Fekë Kuçi (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), nga fshati Studenicë, Komuna e Istogut.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin [AA. nr. 524/2018] të Gjykatës së Apelit të datës 10 Prill 2019, si dhe njoftimin e Prokurorit Shtetëror KMLA. nr. 09/2019 të 21 majit 2019.
3. Aktgjykimi [AA. nr. 524/2018] i Gjykatës së Apelit, i 10 prillit 2019 i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 3 maj 2019.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenit 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ), si dhe nenin 10 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut (në tekstin e mëtejme: DUDNJ).
5. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon nga Gjykata të jetë i pranishëm gjatë seancës së Gjykatës kur të vendoset për kërkesën e tij.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenin 22 [Procedimi i kërkesës], nenin 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 26 nëntor 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
8. Më 27 nëntor 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci gjyqtare raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bajram Ljatifi (kryesues), Safet Hoxha dhe Radomir Laban.
9. Më 9 janar 2020, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës së Apelit.
10. Më 9 janar 2020, Gjykata kërkoi nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë që të bashkëngjiste një kopje të dëshmisë për datën kur parashtruesit të kërkesës i ishte dorëzuar Aktgjykimi [AA. nr. 524/2018] i Gjykatës së Apelit, i datës 10 prill 2019.

11. Më 14 janar 2020, Gjykata Themelore ne Prishtine i dorëzoi Gjykatës dëshminë për dorëzimin e Aktgjykimit [AA. nr. 524/2018] të Gjykatës së Apelit, parashtruesit të kërkesës, me datë të dorëzimit 3 maj 2019.
12. Më 23 janar 2020, parashtruesi i kërkesës dorëzoi dokumente shtesë ne Gjykatë.
13. Më 15 korrik 2020, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës

Përmbledhja e fakteve

Nga shkresat e lëndës Gjykata ka parasysh se në lidhje me rastin e parashtruesit të kërkesës janë zhvilluar dy procedura si ne vijim:

(i) Procedura në lidhje me ndarjen e pasurisë pas vdekjes së trashëgimlënësit

14. Parashtruesi i kërkesës dhe vëllezërit e tij zhvilluan një procedurë në gjykatat e rregullta për ndarjen e pasurisë pas vdekjes së babait të tyre. Në bazë të propozimit për shqyrtimin e trashëgimisë, Gjykata Komunale në Istog me Vendimin [T. nr. 21/2001] të 22 majit 2001, ndau pasurinë trashëgimore të trashëgimlënësit përkatësisht babait të parashtruesit të kërkesës. Sidoqoftë, për shkak të mosmarrëveshjeve për ndarjen e pasurisë midis trashëgimtarëve juridikë, një numër ankesash të ndryshme janë iniciuar para gjykatave të rregullta. Sipas parashtruesit të kërkesës, kjo procedurë u kthye në Gjykatën Themelore të Pejës dega në Istog për rivendosje.

(ii) Procedura disiplinore në Policinë e Kosovës dhe kontesti administrativ në lidhje me të njëjtën

15. Për shkak të dyshimit se ata janë sjellë në mënyrë joprofesionale dhe me këtë kanë keqpërdorur pozitën e tyre zyrtare gjatë udhëheqjes së lëndës në lidhje me mosmarrëveshjen për ndarjen e pasurisë së parashtruesit të kërkesës dhe vëllezërve të tij, parashtruesi i kërkesës nisi procedurën disiplinore para Inspektoratit Policor të Kosovës kundër tre zyrtarëve policor.
16. Më 13 korrik 2016, Komisioni Disiplinor i Policisë së Kosovës nxori Vendimin 495/KBD/2016, Vendimin 496/KBD/2016 dhe Vendimin 497/KBD/2016, me të cilët konstatoi se pretendimet e parashtruesit të kërkesës ishin të pabazuara dhe se zyrtarët e akuzuar të policisë nuk kishin kryer asnjë shkelje disiplinore.
17. Në një datë të papërcaktuar parashtruesi i kërkesës paraqiti një ankesë në Komisionin e Ankesave të Policisë së Kosovës kundër vendimeve të lartpërmendura, të Komisionit Disiplinor të Policisë së Kosovës.
18. Më 8 shtator 2016, me Vendimin 166-KA-D/2016, Komisioni për Ankesa i Policisë së Kosovës e hodhi poshtë ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar dhe i mbështeti në tërësi Vendimet (495 /KBD/2016, 496/KBD/ 2016 dhe 497/KBD/2016) të Komisionit Disiplinor të Policisë së Kosovës të datës 13 korrik 2016.

19. Në një datë të papërcaktuar parashtruesi i kërkesës paraqiti një padi në Gjykatën Themelore të Prishtinës-Departamentin për Çështje Administrative kundër vendimit të lartpërmendur të Komisionit për Ankesa të Policisë së Kosovës.
20. Më 9 gusht 2018, Gjykata Themelore në Prishtinë Departamenti i për Çështje Administrative përmes Aktgjykimit [A. nr. 1555/2016] e hodhi poshtë si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës.
21. Në një datë të papërcaktuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë për shkak të *“aplikimit të gabuar të ligjit material dhe shkeljes së ligjit”*.
22. Më 10 prill 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [AA. nr. 524/2019] e hodhi poshtë si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Themelore.
23. Më 17 maj të vitit 2019, parashtruesi i kërkesës paraqiti pranë Zyrës së Kryeprokurorit Publik një propozim për të iniciuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër Aktgjykimit [A. nr. 1555/2016] të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Aktgjykimit [AA Nr. 524/2019] të Gjykatës së Apelit.
24. Më 21 maj 2019, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e njoftoi (njoftimi KMLP. Nr. 09/19) parashtruesin e kërkesës se nuk ka gjetur asnjë bazë ligjore për iniciimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

25. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimet e kontestuarra i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 24 dhe 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si dhe me nenin 10 të DUDNJ-së.
26. Parashtruesi i kërkesës pretendon gjithashtu edhe shkelje të Kodit Penale, dhe Kodit të Procedurës Penale sepse *„kallëzimet penale janë hudhur poshtë pa u shqyrtuar, kallëzime të cilat ndiqen sipas detyrës zyrtare“*. Parashtruesi pretendon edhe shkelje të Ligjit për Procedurën Jokontestimore (nenet 159, 159(2), dhe nenit 159(3), shkele të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe Ligjit për Trashëgiminë të Kosovës (nenet 36, 132,139(1), dhe neni 140).
27. Parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij konsideron se, *“Në lidhje me lëndën T. nr. 21/2001 të 8 majit 2001, gjykatat e rregullta, prokuroritë dhe orgamet e policisë si institucione publike brenda sistemit të drejtësisë, kanë bërë shkelje të rënda të ligjeve në fuqi në Kosovë, të cilat shkelje inkorporohen në shkeljen e neneve 24 dhe 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe mendoj se që nga fillimi e deri tani, gjithmonë ka pasur shkelje serioze të ligjeve dhe rregullave në lidhje me këtë rast dhe shkelje të dispozitave ligjore të nenit 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ), e drejta për një proces të rregullt.“*
28. Parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij deklaroi se, *“e drejta përë gjykim të drejtë dhe të paanshëm që garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ është shkelur nga dështimi i gjykatës që të ftojë palët në procedurë,*

mos-diskutimi i kallëzimeve penale, mos lejimi i ngritjes së kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, si dhe refuzimi në një mënyrë të padrejtë i ekspertizës, e gjithë kjo rrezikoi të drejtën e mbrojtjes dhe ndershmërinë e procedurave në tërësi, dhe e privoi parashtruesin e kërkesës nga mundësia që të paraqes argumente në mbrojtje të tij, në të njëjtat kushte si në fillim të procedurës kur parashtruesi i kërkesës ishte i pranishëm në një nga seancat gjyqësore.”

29. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata,

“I. Të mbajë seancën dëgjimore;

II. NJËZËRI ta shpallë kërkesën të pranueshme;

III. TË KONSTATOJ me shumicë votash se ka pasur shkelje të nenit 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) të Kushtetutës dhe nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

IV. TË DEKLAROJ me shumicë votash të pavlefshëm njoftimin KMLA nr. 09/2019 të Zyrës së Kryeprokurorit Shtetëror, të datës 21.05.2019.

V. TË KTËJ me shumicë votash njoftimin nga Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm KMLA nr. 09/2019 të datës 21.05.2019 për vendosje të sërishme në përputhje me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese.

TË URDHËROJ që aktgjykimi t’iu kumtohet palëve në përputhje me nenin 20.4 të Ligjit dhe të publikohet në Gazetën Zyrtare.

TË DEKLAROJ se ky aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.”

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

30. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur të gjitha kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

31. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

„1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

(...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

32. Gjykata gjithashtu vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç specifikohet më tej në Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individi mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

33. Përveç kësaj, Gjykata i referohet gjithashtu edhe nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh:

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor... .”

34. Për më tepër, Gjykata i referohet Rregullit 39 (1) (b) dhe (c) të Rregullores së punës, të cili parasheh:

“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

(b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me Ligj kundër aktgjykimit ose vendimit të kontestuar,

(c) kërkesa parashtrohet brenda katër(4) muajsh nga dita kur vendimi i mjetit të fundit i është dorëzuar parashtruesit,

[...].”

35. Duke marrë parasysh kronologjinë e veprimeve juridike të ndërmarra të parashtruesve të kërkesës, si dhe afatet kohore në të cilat gjykatat e rregullta vendosën mbi esencën e kërkesave të tyre, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës në fakt ka zhvilluar dy procese gjyqësore të ndara, në të cilat, edhe pse në thelb, ishin të lidhura rreth të njëjtit proces (procedura për ndarjen e trashëgimisë, dhe procedurat disiplinore dhe administrative kundër zyrtarëve policore për dyshimet për sjellje në mënyrë joprofesionale) procedurat e ndërmarra dallojnë në aspektin procedural, si në aspektin e shterjes së mjeteve juridike, ashtu edhe për sa i përket afateve kohore.

36. Është pikërisht ky dallim procedurash që e ka bërë Gjykatën që gjatë vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës të shqyrtojë dhe analizojë këto procedura ndaras.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës në lidhje me procedurën së parë gjyqësore për ndarjen e pasurisë pas vdekjes së trashëgimlënësit

37. Sa i përket procedurës së parë gjyqësore në lidhje me ndarjen e pasurisë pas vdekjes së babait të parashtruesit të kërkesës, Gjykata pas shqyrtimit të dokumenteve të bashkëngjitura, si dhe në bazë të vet pretendimeve të parashtruesit të kërkesës konstaton se kjo procedurë është ende duke vazhduar, bazuar në ankesat e vet parashtruesit të kërkesës dhe trashëgimtarëve të tjerë të pronës kontestuese. Sipas parashtruesit të kërkesës, kjo procedurë u kthye në Gjykatën Themelore të Pejës dega në Istog për rivendosje.
38. Gjykata rikujton se parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi i kërkesës të shterojë të gjitha mundësitë në procedurën e rregullt në mënyrë që të parandalojë shkeljen e pretenduar të Kushtetutës, në mënyrë që të korrigjojë një shkelje të tillë të të drejtave themelore të njeriut.
39. Arsyetimi për rregullin e shterjes është të i jap autoriteteve kompetente, përfshirë gjykatave, mundësinë për të parandaluar ose korrigjuar shkeljen e pretenduar të Kushtetutës. Rregulli bazohet në premisën se rendi juridik i Kosovës siguron mjete juridike efektive kundër shkeljeve të të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit ndihmës të Kushtetutës (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI23/10, parashtrues *Jovica Gadjić*, Aktvendim për papranueshmëri i 19 shtatorit 2013; dhe shih rastet e GJEDNJ-së: *Gäfgen kundër Gjermanisë*, Aktgjykim i 1 qershorit 2010, paragrafi 142; *Kunert kundër Polonisë*, Aktgjykim i 4 korrikut 2019, paragrafi 42; dhe *Gadd kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Vendim i 28 shtatorit 2017, paragrafi 54). Mbi bazën e të gjithave që u thanë më sipër, Gjykata konkludon se parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj në procedurën aktuale (shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës Kushtetuese, KI32/11, Parashtrues *Lulzim Ramaj*, Aktvendim për papranueshmëri i 20 prillit 2012; KI113/12, Parashtrues *Haki Gjocaj*, Aktvendim për papranueshmëri i 25 janarit 2013, paragrafi 34; KI114/12, Parashtrues *Kastriot Hasi*, Aktvendim për papranueshmëri i 3 prillit 2013, paragrafi 33; KI07/13, Parashtrues *Ibish Kastrati*, Aktvendim për papranueshmëri i 5 korrikut 2013, paragrafët 28-29; KI58/13, Parashtrues *Sadik Bislimi*, Aktvendim për papranueshmëri i 25 nëntorit 2013, paragrafi 31, dhe KI102/16, parashtrues *Shefqet Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri i 2 marsit 2017, paragrafi 39).
40. Andaj, në lidhje me procedurën e parë për ndarjen e trashëgimisë, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj dhe se prandaj kërkesa është papranueshme sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47.2 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (b) të Rregullores së punës.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës në lidhje me procedurën disiplinore në Policinë e Kosovës dhe kontestit administrativ në lidhje me të njëjtën

41. Sa i përket procedurës së dytë gjyqësore, në mënyrë që të mund të verifikojë se kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor, Gjykata merr parasysh “vendimin e fundit” me të cilin është vendosur në lidhje me kërkesën e parashtruesit të

kërkesës, datën në të cilën parashtruesi i kërkesës mori vendimin në fjalë dhe datën e parashtrimi të kërkesës në Gjykatën Kushtetuese. Ky konstatim u konfirmua edhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës në rastet: KI154/14, parashtrues të kërkesës: *Bujar Nrecaj dhe Haxhi Nrecaj* aktvendim për papranueshmëri i 30 qershorit 2016, paragrafi 35, dhe KI201/13, Parashtrues: *Sofa Gjonbalaj* aktvendim për papranueshmëri i 2 Prillit 2014, paragrafi 32.

42. Sa i përket „vendimit të fundit“, Gjykata konsideron se aktgjykimi AA.nr. 524/18 i Gjykatës së Apelit i datës 10 Prill 2019, është vendimi i fundit në lidhje me kërkesën e parashtruesit të kërkesës.
43. Prandaj, Gjykata vëren se aktgjykimi i mësipërm është nxjerrë më 10 prill 2019, ndërsa parashtruesi i kërkesës e mori këtë aktgjykim më 3 maj 2019. Në këtë kuptim si *dies a quo* i afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh merret data e marrjes së aktgjykimit nga parashtruesi i kërkesës, d.m.th. data 3 maj 2019. Afati kohor fillon të rrjedhë nga momenti kur vendimi bëhet i formës së prerë si rezultat i shterjes së mjeteve juridike adekuate dhe efektive për të siguruar korrigjimin e çështjes që është objekt i ankesës (shih, *mutatis mutandis*, *Norkin kundër Rusisë*, kërkesa 21056/11, GJEDNJ, vendimi i 5 shkurtit 2013 dhe shih gjithashtu *Moya Alvarez kundër Spanjës*, kërkesa nr. 44677/98, GJEDNJ, vendimi i 23 nëntorit 1999).
44. Sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës se njoftimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit i zbatuar më 25 maj 2019, është vendimi i fundit për sa i përket mjetit efektiv, Gjykata vëren se është fakt që parashtruesi i kërkesës e mori njoftimin nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit në datën e lartpërmendur, por sipas këtij njoftimi Kryeprokurori i Shtetit nuk e inicioi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë në lidhje me çështjen e parashtruesit të kërkesës, me arsyetimin: „se nuk gjeti asnjë bazë ligjore për iniciimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë.“
45. Prandaj, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur pranë Prokurorit të Shtetit është një mjet juridik i cili nuk është në dispozicion të drejtpërdrejtë të parashtruesit të kërkesës, por varet nga „ndërmjetësi“, e që në rastin specifik „ndërmjetësi“ është Prokurori i Shtetit, dhe si e tillë nuk shqyrtohet nga Gjykata (shih *Tanase kundër Moldavisë*, [VV], paragrafi 122).
46. Si i tillë, njoftimi i Kryeprokurorit të Përgjithshëm nuk konsiderohet të jetë „vendimi i fundit“ në lidhje me kërkesën e parashtruesit të kërkesës, pasi që „vendimi i fundit“ sipas nenit 49 të ligjit përndryshe do të ishte vendimi i fundit me të cilin ishte refuzuar ankesa e parashtruesit të kërkesës, e që në këtë rast është aktgjykimi i Gjykatës së Apelit (shih, *mutatis mutandis*, *Paul dhe Audrey Edvard kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa Nr. 46477/99, GJEDNJ, vendimi i 14 marsit 2002).
47. Për arsyet e cekura më lart, Gjykata konsideron se „vendimi i fundit“ në lidhje me çështjen e parashtruesit të kërkesës është aktgjykimi i Gjykatës së Apelit dhe afati fillon të rrjedhë nga data e marrjes së atij aktgjykimit (shih, *mutatis mutandis*, *Bayram dhe Yildirim kundër Turqisë*, kërkesa nr. 38587/97, GJEDNJ, vendimi i 29 janarit 2002). Prandaj, vërehet se parashtruesi i kërkesës

e mori këtë aktgjykim me 3 maj 2019, ndërsa kërkesën në Gjykatën Kushtetuese e parashtroi me 26 nëntor 2019.

48. Në bazë të asaj që u tha më sipër, rrjedh se kërkesa nuk ishte paraqitur brenda afatit ligjor të parashikuar në nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës.
49. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykata vjen në përfundim se kërkesa e parashtruesit të kërkesës nuk i përmbush kushtet procedurale, sepse është e jashtëafatshme.

Kërkesa për shqyrtim publik

50. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata të zhvillojë një seancë publike ne rastin e tij.

51. Në këtë kuptim, Gjykata i referohet nenit 20 të Ligjit:

“1. Gjykata Kushtetuese vendosë mbi çështjen pas mbarimit të seancës së shqyrtimit verbal. Palët kanë të drejtë të heqin dorë nga shqyrtimi verbal.

2. Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, sipas vlerësimit të saj, gjykata mund të vendosë mbi çështjen që është objekt shqyrtimi kushtetues mbi bazën e shkresave të lëndës.”

52. Gjykata vëren se nuk ka arsye në të cilat është thirrur parashtruesi i kërkesës e të cilat e mbështesin këtë kërkesë.
53. Gjykata konsideron se dokumentet e përfshira në kërkesë janë të mjaftueshme për të vendosur për këtë rast në përputhje me formulimin e nenit 20, paragrafi 2 i Ligjit (shih, *mutatis mutandis*, rasti i Gjykatës Kushtetuese nr. KI34/17, parashtruese e kërkesës: *Valdete Daka*, aktgjykimi i datës 12 qershor 2017, paragrafët 108-110).
54. Prandaj, kërkesa e parashtruesit të kërkesës për mbajtjen e shqyrtimit verbal refuzohet si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, neneve 20,47 dhe 49 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (b) dhe (c) të Rregullores së punës, më 15 korrik 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TË REFUZOJ kërkesën për shqyrtim publik;
- III. T' UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- IV. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese


Remzije Istrefi Peci



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi